



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezimi Punsheni / Prigatite Received / Delivered	20.02.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot. (U. Prot.) Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	1932/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr.34/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.34/2023 të datës 10.01.2023, të parashtruar përmes postes së Kosovës me numër R 2668273, nga ankuesit

kundër organit të punësimit Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjakshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.02.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. DETYROHET Udhëheqësja e Zyrës së Personelit në Komunën e Lipjanit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datë 25.10.2022 të parashtruar nga ankuesit

dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Lipjanit, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në pozitën „Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale“ në Qendrën për Punë Sociale të Komunës e Lipjanit sipas Akt emërimit AE.Nr.1-120-04-62068 të datës 16.11.2022, ankuesja _____ e punësuar në pozitën Zyrtare për Shërbime Sociale 2 në Qendrën për Punë Sociale të Komunës së Lipjanit sipas Akt emërimit të datës 14.09.2018 dhe ankuesja _____ e punësuar në pozitën Nëpunëse e Shërbimeve Sociale në Qendrën për Punë Sociale të Komunës së Lipjanit sipas Akt emërimit të datës 01.02.2012 , përmes Drejtoreshës së Qendrës për punës Sociale me datë 25.10.2022 kanë parashtruar kërkesë me numër protokoll Nr.1250-55/1 tek Kryetari i Komunës së Lipjanit dhe Udhëheqësja e Zyrës së Personelit në Komunën e Lipjanit lidhur me njohjen e se drejtës se shtesës mbi pagën bazë, për shkak natyrës së punës, rrezikshmërisë , ndjeshmërisë, kujdestarisë dhe punën jashtë orarit , duke kërkuar që në pajtim me dispozitat ligjore te aprovojnë shtesën për kushte të veçanta të punës si dhe kërkesa ti dërgohet Ministrisë përgjegjëse.

Ankuesit të pakënaqur me heshtjen e Udhëheqëses së Zyrës së Personelit pranë Komunës së Lipjanit lidhur me kërkesën e datës 25.10.2022 të protokolluar me numër Nr.1-120/02-5812 ,me datë 10.01.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore për njohjen e së drejtës shtesës mbi pagën bazë, duke propozuar që të obligohet Komuna e Lipjanit respektivisht Zyra e Personelit që të ndërmarrë veprimet e duhura ligjore për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për zyrtarët e Qendrës për Punë Sociale të cilët intervenojnë në raste të ndjeshme dhe të rrezikshme, duke punuar jashtë orarit si dhe gjatë festave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.01.2023, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit, ndërsa me datën 26.01.2023 Komuna e Lipjanit ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi _____ në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoll 106/2023 të datës 10.01.2023; Kërkesë për rregullimin e shtesës mbi pagën bazë drejtuar Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Lipjanit me datë 25.10.2022 me numër protokoll 1250.551; Llogaritja e orëve të punës gjatë kujdestarisë për muajin gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor; Shkresë me mbishkrim Ndrysho orët shtesë e datës 08.11.2022; Shkresë me mbishkrim Ndrysho orët shtesë e datës 06.11.2022; Detajet e orëve shtesë të datës 28.10.2022 për nëpunësen _____ Detajet e orëve shtesë të datës 26.10.2022 për nëpunësen _____ Detajet e orëve shtesë të datës 18.10.2022 për nëpunësen _____ Detajet e orëve shtesë të datës 13.10.2022 për nëpunësen _____ Detajet e orëve shtesë të datës 20.09.2022 për nëpunësen _____ Detajet e orëve shtesë të datës 01.09.2022 për nëpunësen _____ Detajet e orëve shtesë të datës 07.08.2022 për nëpunësen _____ Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoll 495/2023 të datës 18.01.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoll 362/2023 të datës 16.01.2023; Material për orët shtesë të ankuesve i dërguar me e-mail zyrtar nga Zyrtari për Personel i Komunës së Lipjanit për KPMSHCK-në me numër protokoll 950/2023 të datës 26.01.2023; Përgjigje në ankesë nga Komuna e Lipjanit për KPMSHCK-në me datë 25.01.2023; Akt emërim i ankuesit _____ i lëshuar nga Komuna e Lipjanit me AE.Nr.1-129-04-

62068 të datës 16.11.2022; Akt emërim i ankueses [redacted] i lëshuar nga Komuna e Lipjanit me datë 01.02.2012; Akt emërim i ankueses [redacted] i lëshuar nga Komuna e Lipjanit me datë 14.09.2018; Pagesat e periudhës 01.12.2022 deri më 31.12.2022 të lëshuar nga Buxheti I Republikës së Kosovës; Pagesat e periudhës 01.11.2022 deri më 30.11.2022 të lëshuar nga Buxheti I Republikës së Kosovës; Kërkesë për kompensim të orëve nga [redacted] për Udhëheqësen e Personelit në Komunën e Lipjanit me numër protokoll 1430/130/1 të datës 09.12.2022; Kërkesë për kompensim të orëve me ditë të lira nga [redacted] për Udhëheqësen e Personelit në Komunën e Lipjanit me numër protokoll 1127-130 të datës 27.09.2022; Shkresë e orëve shtesë e lëshuar nga SIMBNJ; Kërkesë për kompensim të orëve nga [redacted] për Udhëheqësen e Personelit në Komunën e Lipjanit me numër protokoll 1432-130 të datës 04.12.2022; Akt vendim për pagesë të punës jashtë orarit I lëshuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Lipjanit me numër protokoll 1432-130/3 të datës 09.12.2022; Kërkesë për korrigjim të koeficientit për [redacted] drejtuar Kryetarit të Komunës së Lipjanit me numër protokoll 768-119 të datës 29.12.2020; Kërkesë për kompensim të punës jashtë orarit zyrtar nga [redacted] drejtuar Kryetarit të Komunës së Lipjanit, Udhëheqëses së Personelit dhe Shefes së Zyrës Ligjore me numër protokoll 326-551/1 të datës 14.03.2022; Punët shtesë të [redacted] me korrespondencë prej 1-14 faqe; Kërkesë për kompensim material të punës në kujdestari nga M.SH për Kryetarin e Komunës së Lipjanit me datë 21.12.2020; Kërkesë për pagesë të intervenimeve pas orarit të natës nga zyrtarët social nga M.B dhe M.SH me numër protokoll 1-120-61662 të datës 06.10.2021; Kërkesë për pagesë të intervenimeve në rast gjatë orëve të kujdestarisë nga zyrtarët social nga Kryetari I Komunës së Lipjanit I.A dhe M.SH Drejtore e QPS në Lipjan drejtuar SH.H Drejtori I DSHP-së me numër protokoll 733-551/2 të datës 01.08.2022; ; Kërkesë për pagesë të intervenimeve në rast gjatë orëve të kujdestarisë nga zyrtarët social nga SH.P dhe SH.M për Kryetarin e Komunës së Lipjanit [redacted] me numër protokoll 733/551/1 të datës 17.06.2022; ; Kërkesë për pagesë të intervenimeve në rast gjatë orëve të kujdestarisë nga zyrtarët social nga M.SH për Kryetarin e Komunës së Lipjanit [redacted] me numër protokoll 1-120-39742 të datës 19.07.2021; ; Kërkesë për pagesë të intervenimeve në rast gjatë orëve të kujdestarisë nga zyrtarët social nga M.SH për Kryetarin e Komunës së Lipjanit me numër protokoll 1-120-61662 të datës 06.10.2021; Kërkesë për mëditje të ZSHS në kujdestari nga [redacted] për Kryetarin e Komunës së Lipjanit [redacted] me datë 12.10.2012; Kërkesë për përfaqësim zyrtar të punës në kujdestari nga M.SH për S.V me numër protokoll 852-114 të datës 28.10.2013; Kërkesë për përfaqësim të punës jashtë orarit të rregullt nga M.SH për Kryetarin e Komunës së Lipjanit të datës 14.11.2013; Kërkesë për pagesat shtesë-jashtë orarit të punës nga [redacted] për Kryetarin e Komunës së Lipjanit me datë 06.11.2013; Kërkesë për mbështetje material për kujdestarët e zyrtarëve social nga [redacted] për [redacted] me numër protokoll 453/551/1 të datës 05.04.2022; Kërkesë për përfaqësim të punës jashtë orarit të rregullt për ZSHS nga [redacted] për Kryetarin e Komunës së Lipjanit me numër protokoll 1033-114 të datës 30.12.2013; Kërkesë për pagesa shtesë-jashtë orarit të punës nga M.SH për Kryetarin e Komunës së Lipjanit SH.B të datës 05.11.2013; Kërkesë për pagesë të kujdestarisë së zyrtarëve social me numër protokoll 140-951 të datës 01.02.2021; Punët shtesë të [redacted] me korrespondence, prej 1/11 faqe.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të dispozitës së nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda të kthehet tek institucioni përkatësisht Komuna e Lipjanit, me

qëllim që të detyrohet organi i punësimit të merr në shqyrtim kërkesën e ankuesve për nxjerrën e akti administrativë, nga organi kompetent konformë dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesit me datën 25.10.2022 përmes Drejtoreshës së Qendrës për punës Sociale kanë parashtruar kërkesën me numër protokolli Nr.1250-55/1 tek Kryetari i Komunës së Lipjanit dhe Udhëheqësja e Zyrës së Personelit në Komunën e Lipjanit lidhur me njohjen e të drejtës për realizimin e shtesës në pagë për shkak natyrës së punës, rrezikshmërisë, ndjeshmërisë, kujdestarisë dhe punën jashtë orarit duke kërkuar që në pajtim me dispozitat ligjore të aprovojnë shtesën për kushte të veçanta të punës si dhe kërkesa të dërgohet Ministrisë përgjegjëse, mirëpo Komuna e Lipjanit nuk i ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën e datës 25.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesit kanë bërë kërkesë në adresë të zyrtarëve kompetentë të Institucioni në këtë rast Komunës së Lipjanit lidhur me njohjen e të drejtës për realizimin e shtesës në pagë për kushte të veçanta të punës ku kanë kërkuar që të ju aprovohet kërkesa dhe këtë kërkesë Komuna e Lipjanit ta procedoj tek Ministria përgjegjëse, mirëpo gjithnjë duke u bazuar në provat e lëndës dhe përgjigja nga institucioni kompetentë në lidhje me këtë ankesë, Kolegji ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Lipjanit dhe Udhëheqësja e Zyrës së Personelit në Komunën e Lipjanit nuk e kanë shqyrtuar kërkesën e ankuesëve të datës 25.10.2022 gjegjësisht nuk kanë marr ndonjë veprim konkretë administrativë lidhur me shqyrtimin e kërkesës së lartpërmendur dhe nxjerrës se aktit administrativë në lidhje me kërkesën e datës 25.10.2022.

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Udhëheqësja e Zyrës së Personelit e Komunës së Lipjanit, është e obliguar që të shqyrtoj kërkesën e ankuesëve të datës 25.10.2022 dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht të shqyrtoj në mënyrë të drejtë kërkesën e ankuesëve si dhe të gjitha faktet që kanë të bëjnë me pretendimet e ankuesëve të parashtruara përmes kërkesës së tyre, gjegjësisht Kolegji vlerëson se është obligim i organit kompetentë që të përgjigjet për nëpunësit e punësuar në pajtim me dispozitat e nenit 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe është i obliguar që në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe ligjeve të aplikueshme që rregullojnë këtë çështje të shqyrtoj kërkesën e ankuesëve të datës 25.10.2022 si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me procedurat ligjore, brenda afatit të përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A. nr. 34/2023

Zyle Millaku GOJNOVCI

Prosesmbajtëse

Malsore GASHIBAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesve
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

